



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.04.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi - nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19 mars 2019.
2. Seancë dëgjimore me Autoritetin e Mediave Audiovizive për shqyrtimin e Raportit të veprimtarisë vjetore të AMA-s për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Enver Roshi.

Të ftuar:

Gentian Sala - Kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive,
Vera Muço – sekretare e Përgjithshme,
Sara Xhumbari – drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Licencave,
Arben Muka - drejtor i Drejtorisë së Programeve,
Urim Bajrami - kryetar i Këshillit të Ankesave.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Jemi mbledhur për të zhvilluar mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Në rendin e ditës kemi dy çështje: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 19 mars 2019 dhe shqyrtimin e raportit për veprimtarinë 1-vjeçare të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018, e cila është një çështje me rëndësi për këtë komision, sepse Autoriteti i Mediave është shumë i rëndësishëm për kontrollin tonë parlamentar dhe për këtë arsye ne kemi bërë edhe vizita te ju, për të kuptuar se si funksionon institucioni nga afër dhe për të parë vështirësitë dhe arritjet që keni pasur gjatë dy vjetëve të kaluara. Kemi të ftuar zotin Gentian Sala, Kryetar i AMA-s, zonjën Vera Muça, zonjën Sara Xhumbari, zotin Arben Muka dhe zotin Urim Bajrami.

Pasi ju keni sjellë raportin me shkrim për veprimtarinë e institucionit, ne kemi caktuar një relator, zotin Musa Ulqini. Ne mendojmë që miratimin e raportit ta kalojmë në dy mbledhje komisioni, ku e para të jetë kjo e sotmja dhe e dyta ajo e miratimit të pojektrezolutës. Kështu që, ju lutem shumë, edhe pse ne e kemi lexuar raportin dhe kemi shkëmbyer edhe mendime me Shërbimin e Monitorimit në Kuvend, do të ishte e nevojshme që edhe ju të bënit një prezantim të raportit, sepse ne e kuptojmë që edhe për ju është shumë e rëndësishme të tregoni përpjekjet e këtij viti pune, i cili në të vërtetë nuk ka qenë një vit pa sfida, ku ne kujtojmë se keni pasur sfida në fushën e objektivave, por edhe sfida të rëndësishme financiare. Kështu që mendoj të na prezantoni shkurtimisht arritjet dhe ne të bëjmë pyetjet dhe komentet tona.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Gentian Sala – Faleminderit, zonja Kryetare!

Përveç përshkrimit të shkurtër nga ana ime të punës së Autoritetit, mendoj që edhe zoti Urim Bajrami të bëjë një përshkrim të shkurtër të Këshillit të Ankesave. Kjo për arsyen se Këshilli i Ankesave është një bord brenda bordit, funksionon i pavarur dhe është e rëndësishme që të bëjë një përshkrim për detyrat që kryhen.

Së pari, po filloj me prezantimin e veprimtarisë së Autoritetit.

Gjatë vitit 2018 Autoriteti i Mediave ka punuar maksimalisht për realizimin e detyrave të veta funksionale, si një rregullator eficient dhe i pavarur për të ndikuar në konkurrencën e lirë dhe të ndershme të operatorëve të tregut audioviziv. Një nga detyrat kryesore të Autoritetit është digjitalizimi, i cili gjatë vitit 2018 ka pasur avancime, jo ashtu siç do të donim ne, por të

konsiderueshme. Aktualisht janë mbyllur transmetimet analoge në tri qarqe të vendit: në Berat, në Fier dhe në Korçë dhe këtë vit mbyllet në Tiranë, në Durrës dhe në Vlorë. Ka edhe qarqe ku nuk janë mbyllur transmetimet analoge, ku operatorët privatë vazhdojnë funksionimin e tyre. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme të theksohet se 90% e popullsisë së Republikës ka sinjal analog sot. Është e vërtetë që mund të ketë zona që janë edhe analogë, edhe numerikë, por 90% e popullsisë ka sinjalin numerik. Zonat ku është prezent ky sinjal kanë trefishim të numrit të programeve pa pagesë. Duhet të theksoj se ky numër programesh pa pagesë është i lartë si në asnjë vend të rajonit. Sot, sinjal numerik, në zonat ku është mbyllur procesi, shikojnë të paktën 30% e popullsisë, ndërsa në zonat urbane të Tiranës dhe Durrësit është akoma më i lartë. Në Greqi dhe në Maqedoni programe pa pagesë shohin më pak se 5% e qytetarëve, të gjithë qytetarët e tjerë shikojnë me pagesë. Ndërkohë që është për t'u theksuar fakti që numri i qytetarëve në Republikën e Shqipërisë, të cilëve u ofrohet shërbim pa pagesë, është shumë i lartë. Pra, megjithëse kemi kompani shumë të forta private, që ofrojnë shërbim me pagesë, ne jemi munduar maksimalisht që numri i qytetarëve, të cilët të mund të shohin pa pagesë të jetë sa më i lartë dhe kjo tanimë është e garantuar.

Për herë të parë në muajin shtator të vitit të shkuar në Republikën e Shqipërisë në zonat urbane nuk ka më asnjë transmetues të paligjshëm. Kjo pas 20 vjetësh historie, dikush nga pasioni, dikush për t'i bërë karshillik shtetit, të cilët vinin një antenë dhe jepnin sinjal të palicencuar. Nga shtatori i vitit të kaluar nuk ekziston asnjë operator që transmeton në mënyrë të paligjshme qoftë sinjal analog, qoftë numerik.

Gjatë vitit 2018 u realizua edhe lirimi i brezit digjital dividend, i cili iu akordua AKEP-it për shërbimet e lëvizshme, që do të kontribuojë për rritjen e kapaciteteve të internetit me shpejtësi të lartë në rang kombëtar.

AMA është fokusuar në promovimin dhe inkurajimin e futjes së teknologjive të reja: *Video on Demand, Catch up, OTT*, duke ruajtur konkurrencën dhe mundësinë e barabartë për të gjitha palët që ofrojnë këtë shërbim.

Detyra më e rëndësishme e Autoritetit të Mediave është programacioni, kjo për vetë faktin se edhe vetë ligji i jep një rëndësi të madhe programacionit të shërbimeve audiovizive.

Gjatë vitit të kaluar janë realizuar shqyrtime tematike për vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe zbatimin e Kodit të Transmetimit, me fokus të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve në transmetimet analoge, reklamat edhe komunikimet tregtare, programet audiovizive me karakter informimi për shëndetin dhe përdorimin e medikamenteve, respektimin e standardit të shqipes së folur dhe të shkruar, përmbajtjet e dëmshme me dhunë,

pornografinë apo përdorimin e substancave narkotike në kanalet e profilit muzikor, që është një shqetësim në rritje, kështu që edhe fokusi ynë për këtë pjesë ka qenë në rritje.

Krahas rolit proaktiv të Autoritetit në fokusin e lartpërmendur, Këshilli i Ankesave është angazhuar maksimalisht në zbatimin e ligjit dhe Kodit të Transmetimit, duke trajtuar me seriozitet dhe përgjegjësi çdo ankesë.

Gjatë vitit 2018, 40% e ankesave kanë qenë në lidhje me shkeljet e të drejtave të fëmijëve; 38 % e ankesave kanë qenë për shkelje të të drejtave të njeriut, normave ligjore dhe etike, 12% kanë qenë ankesa me natyrë komunikimesh tregtare dhe 10% ankesa të tjera.

Këshilli i Ankesave ka zhvilluar disa konferenca dhe tryeza me pjesëmarrjen dhe kontribuimin e figurave të njohura të jetës akademike, universitare, medias, publikut dhe shoqërisë civile. Këto konferenca trajtuan tema të rëndësishme, si: mbrojtja e fëmijëve dhe edukimi për median dhe gjuhën e urrejtjes. Gjithashtu, anëtarët e Këshillit të Ankesave kanë marrë pjesë dhe kanë rritur ndërveprimin me tryeza të iniciuara nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile, ku janë diskutuar tema për lirinë e medias, përdorimin e gjuhës diskriminuese e të tjera.

Në zbatim të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe ligjit “Për mediat audiovizive”, vitin e kaluar AMA ka kryer edhe dy vlerësime për procesin e ndërtimit të buketës programore të operatorit publik. Gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet u janë përcjellë drejtuesve të RTSH-së dhe Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Në fokusin tonë prej 5 vjetësh është partneriteti me palë të tjera, që janë partnerët tanë në organizimin e tryezave dhe studimeve në fushën e mediave audiovizive për barazinë gjinore, për *fake news*, për edukimin mediatik dhe përshtatjen me aplikacionet e reja të mediave të reja. Risi ishte partneriteti në funksionimin e pasurimit të literaturës në gjuhën shqipe për mediat audiovizive, duke përkthyer tituj të fondit të bibliografisë ndërkombëtare.

Në zbatim të projektit “Ofertat programore të transmetuesve televizivë”, u realizua një studim dhe konferencë shkencore për aspektet e ndryshme të përmbajtjeve që emetojnë subjektet audiovizive në Shqipëri. Po në funksion të këtij projekti, u krye një sondazh me një kampion prej 500 të pyeturish në terren, i kombinuar me intervista cilësore. Këto të dhëna i janë nënshtruar një procesi përpunues dhe brenda 6-mujorit të parë të këtij viti do të botohet një material për të gjitha palët e interesuar dhe grupet e interesit. Konsolidimi institucional në rolin e rregullatorit të tregut audioviziv dhe AMA-s, në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesit, çuan në rishikimin e një sërë aktesh nënligjore, që ndikojnë drejtpërdrejt në dinamikën e tregut dhe performancën e OSHMA-ve, të tilla si: rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave; rregullore për komunikimet audio dhe audiovizive me natyrë tregtare; format,

kushtet dhe koha auditore e lejuar për transmetimin e tyre; rregullore për kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura dhe udhëzimi për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive.

Gjatë vitit të kaluar u treguam proaktivë në ndërtimin dhe forcimin e urave të komunikimit me institucionet dhe agjencitë e tjera publike për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Vëmendjen më të madhe, pa dyshim, e zë bashkëpunimi me Kosovën. Kjo për shumë arsye, jo thjesht se atje qytetarët flasin shqip dhe janë shqiptarë, por sepse televizionet janë një treg jashtëzakonisht i madh për mediat e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, AMA në bashkëpunim me KPM-në e Kosovës forcuan bashkëpunimin në fushën e digjitalizimit dhe shkëmbimin e informacionit. Ky bashkëpunim është kryer edhe në funksion të koordinimit për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në rrjetet europiane rregullatore. AMA, gjithashtu, vitin e kaluar, përmes takimeve dhe shkëmbimeve të informacionit, ka pasur një bashkëpunim më të ngushtë me operatorët e shtetit të Maqedonisë dhe Greqisë.

Siç e thashë edhe më parë, mendoj që edhe kryetari i Këshillit të Ankesave të shprehet për këtë.

Milva Ekonomi – Po, mendoj se duhet të dëgjojmë zotin Bajrami, pastaj të bëjmë pyetjet.

Faleminderit!

Urim Bajrami – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Meqenëse është prezantimi i parë i Këshillit të Ankesave në këtë komision të nderuar, me lejen tuaj dua që shkurtimisht të theksoj në mënyrë telegrafike disa pika të rëndësishme për punën e Këshillit, edhe përtej periudhës raportuese.

Sigurisht, raportimi për vitin 2018 është i plotë dhe i detajuar në kapitullin VIII të këtij raporti që keni përpara.

Së pari, dua të theksoj se Këshilli i Ankesave filloi zyrtarisht të funksionojë në prill të vitit 2016, si njësi brenda Autoritetit të Medieve Audiovizive, ku fokusi kryesor ka qenë respektimi i ligjit nr. 97/2013, që është ligji organik i AMA-s, dhe në veçanti respektimi i Kodit të Transmetimit, si akti nënligjor më eksplicit, që përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Së dyti, fokusi kryesor i Këshillit ka qenë dhe mbetet mbrojtja e fëmijëve.

Në fakt, më vjen të mirë të pohoj se ka një përmirësim të dukshëm nga viti në vit për sa u përket programeve për fëmijë në transmetimet audiovizive. Nuk diskutohet që ka ende

probleme, por në raport me vitet e shkuara, kur nuk përdorej shenja më minimale në raste të tilla, situata tashmë duket se është përmirësuar.

Së treti, përveç fokusit kryesor që sapo përmenda, Këshilli mbikëqyr, në mënyrë të pandërprerë, respektimin e normave ligjore dhe etike nga operatorët audiovizivë. Çdo ankesë e mbërritur tek AMA, është trajtuar në mënyrën më efikase të mundshme. Krahas ankesave, janë ndërmarrë edhe vëzhgime periodike për përmbajtjet audiovizive, ndërsa janë shtuar tryezat dhe konferencat tematike me grupe të ndryshme interesi.

Cili ka qenë qëllimi i këtyre tryezave dhe konferencave tematike? Interesi ka qenë për njohjen dhe përmbajtjen e Kodit të Transmetimit, por, nga ana tjetër, edhe ndërgjegjësimi për respektimin e tij.

Duke u kthyer përsëri tek ankesat, mund të them se shqyrtimi i tyre, pra e gjithë procedura e shqyrtimit të tyre, deri te konkluzionet përfundimtare, janë publikuar në buletinet periodike të Këshillit dhe janë të aksesueshme për këdo në faqen e internetit të AMA-s. Sigurisht, këto buletine shërbejnë edhe si guida për vetë operatorët audiovizivë.

Së katërti, nëse gjatë vitit 2017, së bashku me drejtoritë dhe njësitë e tjera në AMA, rishikua Kodin e Transmetimit, pas një konsultimi të gjerë dhe të shtrirë në kohë, si dhe hartua dhe miratua rregulloren për procedurat e trajtimit të ankesave dhe ushtrimin e së drejtës së përgjigjes, në vitin 2018 pothuajse e plotësuam këtë kuadër nënligjor.

U hartua dhe u miratua udhëzimi për trajtimin e ankesave nga vetë ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv. Përveç të tjerash, miratimi i këtyre akteve ishte edhe në përmbushje të detyrave të parashikuara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Medieve Audiovizive për vitin 2017.

Së pesti, dua të theksoj se cili ishte thelbi i këtyre dokumenteve. Thelbi ishte përfshirja në procesin e shqyrtimit të ankesave dhe të vetë operatorëve. Përfshirja e tyre në këtë proces na ka rezultuar goxha pozitiv, sepse ka sensibilizuar vetë OSHMA-të në zbatimin e kërkesave ligjore.

Së fundi, dua të theksoj se qëllimi ynë i përbashkët, i juaji si legjislativ, i AMA-s, i Këshillit, i operatorëve dhe të gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë fushë, është mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, dinjitetit të tij, sigurisht edhe mbrojtja e fëmijëve, që është në fokusin tonë. Ndaj, ne si Këshill, këmbëngulim më fort në sensibilizimin e OSHMA-ve, por edhe të vetë shoqërisë mbi domosdoshmërinë për të respektuar çdo normë ligjore dhe etike në transmetimet audiovizive.

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Faleminderit!

A keni pyetje?

Zoti Ulqini, a mund të thoni diçka si relator i komisionit?

Musa Ulqini – Faleminderit!

Sot është një ditë e rëndësishme, sepse do të diskutojmë për veprimtarinë 1-vjeçare të një institucioni shumë të rëndësishëm, siç është AMA, i cili është institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për monitorimin e të gjithë veprimtarisë së medieve audiovizive.

Dua të them 2-3 konsiderata në lidhje me raportin.

Së pari, bie dakord me çfarë u thanë këtu nga parafolësit dhe nga kryetari, por edhe nga zoti Bajrami. Raporti në 140 faqe jep një informacion të shumtë për aktivitetin që ka pasur ky institucion.

Gjithashtu, dua të them se, nga këndvështrimi i punës sonë, si komision, raporti respekton detyrimet ligjore, pra është hartuar mbi bazën e kërkesave të ligjit, u jep përgjigje kërkesave të ligjit për aktivitetin 1-vjeçar, respekton dokumentin që ka miratuar Kuvendi, si dhe të gjitha kërkesat që kanë qenë të parashtruara në rezolutën e Kuvendit, që është miratuar vitin e kaluar, pra bën shpjegime për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rezoluta. Natyrisht, ky raport respekton edhe dokumentet strategjike që ka miratuar vetë institucioni, siç është dokumenti për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike dhe dokumente të tjera.

Gjithashtu, ky raport merr në konsideratë institucionet kryesore ndërkombëtare. Këtu kam parasysh progresraportin e BE-së në lidhje me aktivitetin e medieve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ne kemi dy dokumente: raportin dhe një material, që e ka përgatitur Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit. Mendoj se është rasti për të thënë se puna e këshilltarit, që ka përgatitur këtë raport, i cili e ka për herë të parë, e kam fjalën e për zotin Myftiu, është një punë jashtëzakonisht e mirë. Raporti i Shërbimit të Monitorimit ka bërë një analizë të hollësishme dhe konkrete.

Në fakt, këtu u thanë disa arritje, por unë kam dëshirë të them disa gjëra që kanë ndodhur për herë të parë në aktivitetin e AMA-s. Ashtu siç e tha edhe kryetari i AMA-s, për herë të parë është bërë lirimi i brezit të dividendit digjital. Domethënë, për herë të parë AMA krijoi kushte konkrete që në Republikën e Shqipërisë të kemi mundësi që të kemi internet me shpejtësi të lartë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Natyrisht, kjo nuk realizohet nga AMA, ajo ka bërë detyrën e saj, që ka liruar frekuencën. Tani është detyrë e një tjetër institucioni që ta përshpejtojë këtë proces, pra të bëjë tenderimin dhe t'u krijojë mundësinë shqiptarëve që ta kenë këtë shërbim me shpejtësi të lartë.

Gjithashtu, për herë të parë në aktivitetin e AMA-s kanë marrë pjesë të gjitha palët e interesuara, ku në qendër të diskutimeve kanë qenë çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve. Nuk ka qenë një mbledhje formale, ku ne mbledhemi, diskutojmë dhe nuk mbetet asgjë, por çështjet kryesore që janë diskutuar janë kthyer në detyrime dhe të gjitha palët e interesuara kanë bërë hapat përkatës. Ne, si komision, i kemi kërkuar institucionit përkatës shtetëror që të na sjellë një raport lidhur me këtë çështje.

Po ashtu, për herë të parë kemi disa memorandume mirëkuptimi, që ka nënshkruar AMA me Autoritetin e Konkurrencës, me Policinë e Shtetit, me Drejtorinë e Parandalimit të Parave dhe me institucionin që mbulon të drejtat e autorit. Natyrisht, këto memorandume kanë qenë në kërkesë të institucioneve ndërkombëtare, por është shumë e rëndësishme që për herë të parë ne kemi memorandume, të cilat i japin një fuqi të madhe aktivitetit të institucionit, sepse institucioni e ka të pamundur që të jetë 100% i suksesshëm, në qoftë se aktivitetin e tij nuk e bashkërendon me punën e të gjitha institucioneve. Këtu kam parasysh edhe bashkëpunimin me Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, por kjo është një marrëdhënie disi ndryshe, sepse RTSH-ja është një transmetues publik, i cili është nën varësinë tuaj për shumë gjëra, pra e kam fjalën për këto institucione që i kanë dhënë punës suaj një cilësi tjetër, një fuqi dhe një ndikim tjetër në fushën delikate që mbulon ju, sepse fusha e medievet është shumë delikate.

Gjithashtu, mendoj se duhet ta ritheksojmë se më në fund, për herë të parë, pas 20 vjetësh, në nëntor të 2018-ës u mbyllën të gjitha transmetimet e paligjshme audiovizive numerike analoge në radio dhe në televizione. Ka qenë një problem i jashtëzakonshëm, ku dukeshin dobësitë e shtetit në tërësi dhe të institucionit tuaj në veçanti. Prandaj, kjo është një arritje shumë e madhe në punën tuaj dhe ne duhet ta themi me zë të fortë, sepse ndodh për herë të parë.

Për sa u takon interferencave, për herë të parë ne nuk kemi probleme me fqinjët dhe kjo ka dy anë:

Së pari, atje ku kemi pasur ne probleme, i kemi mbyllur për shkak të punës suaj, por edhe atje ku palët kufitare kanë ndikuar negativisht tek transmetimet tona, falë punës dhe angazhimit tuaj, është bërë e mundur që këto probleme të zgjidhen, sepse kërkohet një bashkëpunim reciprok mes enteve rregullator të shteteve fqinje. Pra, edhe për këtë çështje për herë të parë ne nuk kemi interferenca mes Shqipërisë dhe të gjitha vendeve që kufizojnë Shqipërinë, jo vetëm me Malin e Zi, por edhe me Maqedoninë dhe me Greqinë me të cilët kemi pasur probleme më parë.

Së fundi, pavarësisht se Këshilli i Ankesave është ngritur, është një institucion që e këshillon institucionin e AMA-s, por përsëri është një institucion brenda institucionit.

Megjithëse është ngritur në vitin 2016, ky institucion e ka përmirësuar punën, duke qenë prezent në jetën sociale. Kjo është edhe arsyeja që numri i ankesave të qytetarëve ka ardhur duke u rritur, gjë që tregon cilësinë e punës së Komitetit të Ankesave dhe jo të kundërtën. Më parë qytetarët nuk e dinin këtë gjë, sepse nuk ishin të informuar, por nuk kishin as kulturën e nevojshme që për gjërat që nuk shkonin, si kur shkelen të drejtat e fëmijëve, të drejtat e privatësisë dhe shumë gjëra të tjera, që janë precizuara shumë saktë në ligj, të ankoheshin.

Besoj se zoti Bajrami bie dakord me mua që miratimi i Kodit të Transmetimeve ka qenë një ndihmë shumë e madhe, sepse i ka kodifikuar gjërat, pra i ka futur gjërat në një kuadër dhe operatorët radiotelevizivë tashmë kanë një dokument, të cilin duhet ta respektojnë, pra gjërat janë në rrugë të mbarë.

Kam tri pyetje për çështje që lidhen me punën tuaj. Natyrisht, viti i kaluar ka qenë sprovë e madhe për strategjinë tuaj për kalimet nga transmetimet analoge në ato digjitale. Beteja kryesore është bërë në rajonin e Tiranës dhe Durrësit. Në fillim kemi pasur datën 31 korrik, kur duhej të mbylleshin, pastaj e keni shtyrë më 10 shtator, më pas më 15 janar të këtij viti dhe tashmë kemi një afat fundor, që është data 1 shtator. Natyrisht, raporti e shpjegon, përpiket të japë argumente dhe detaje pse ka ndodhur kjo gjë. Kjo gjë vjen sepse është një gjë krejt e re, sepse njerëzit nuk e kanë kulturën e nevojshme, sepse Drejtoria e Doganave nuk e ka bërë siç duhet punën e saj dhe për shumë arsye që nuk po i analizoj këtu. E rëndësishme është që, me punën e madhe që keni bërë ju për të rritur informimin e publikut dhe me angazhimin e institucioneve të tjera, ne do të kemi mundësi ta realizojmë këtë detyrim, i cili rrjedh edhe nga konventat ndërkombëtare. Këtu kam parasysh se çfarë detyrimi kemi në raport me BE-në, pra më në fund do të mundësojmë që në datën 1 shtator 2019 të kemi një transmetim në këtë rajon të madh, ku banon më shumë se gjysma e popullsisë dhe do të kalojmë në këtë cilësi të re të transmetimeve, sepse ky është edhe qëllimi.

E dyta, disa transmetues, siç është RTSH-ja, kanë shpenzime shumë të mëdha, sepse transmetojnë edhe në mënyrë analoge, edhe në mënyrë digjitale, duke pasur kosto shumë të larta. Me sa di unë, dhe këtu nuk jam 100% i sigurt, por 98%, ka qenë një VKM e vitit 2013, që i kërkonte Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që të mos lejonte që në territorin e Republikës së Shqipërisë të futeshin nga agjentët tregtarë pajisje televizive që të mos kishin T2-in. Për të folur me gjuhë të thjeshtë: po të futen këto pajisje të reja televizive, nuk ka nevojë të blihet dekoderi, sepse dekoderi e ndërlikon shumë situatën. Unë e di që VKM-ja nuk është ekzekutuar, nuk është marrë në konsideratë sa duhet nga entet përkatëse. Në qoftë se e kam të saktë këtë që po them, kjo është një ndihmë e madhe për institucionin tuaj. Unë besoj se duhet ta përdorni si instrument, përveç sensibilizimit të qytetarëve dhe angazhimit të gjithë faktorëve

që janë në këtë proces. Edhe kjo gjë është shumë e rëndësishme, sepse, në qoftë se të gjitha pajisjet e reja futen në këtë cilësi, lehtësohet shuma puna. Natyrisht, 70% e shqiptarëve nuk do të blejnë aparat televiziv të ri, meqenëse futet kjo teknologji e re, por do të blejnë dekoderin; por edhe kjo është shumë e rëndësishme për t'u parë.

E zgjata shumë, pyetja është: a do të ketë një shtyrje tjetër pas datës 1 shtator? Unë i kam lexuar dhe e kam ndjekur shtimin e spoteve, por jo vetëm shtimin e numrit të spoteve, por edhe cilësinë e tyre, madje edhe qartësinë e tyre për ta kuptuar çdo njeri, edhe ai me shkollë, edhe ai pa shkollë, se për çfarë bëhet fjalë.

Pyetja e dytë: në të gjitha raportet e ndërkombëtarëve theksohet se pronësia e medieve elektronike është përqendruar në duart e disa biznesmenëve të mëdhenj dhe kërkohet kufizim i pronësisë tek operatorët kombëtarë, në përputhje me standardet europiane. Si e vlerësoni ju këtë konstatim dhe çfarë është realizuar konkretisht? Kjo është një çështje e ndjeshme. Jo vetëm organizatat shqiptare, që monitorojnë mediet kanë prodhuar dokumente, të cilat tërheqin vëmendjen për këtë çështje, por është një çështje e shtruar edhe në raportet e ndërkombëtarëve, në progresraport dhe në dokumente të tjera, të cilat flasin për situatën e medieve në Shqipëri.

E fundit, në rezolutën e Kuvendit dhe në materialin tuaj theksohet përpjekja që keni bërë për të respektuar ligjin dhe Kodin e Transmetimit për reklamat tregtare dhe komunikimet tregtare. Ju flisni për progresin që është bërë, për luftën që bëni me reklamat e fshehta, për të ndarë një emision dhe për ta vëzhguar nëse është promovion apo programor.

Dua të shtroj një çështje, që nuk e di se sa mund të di ta shtroj saktësisht, për ta kuptuar të gjithë. Unë vërej që ka reklama të produkteve të ndryshme, të cilat, nga të gjitha ato që dimë dhe jam konsultuar, në të vërtetë e dëmtojnë shëndetin e njerëzve, shtojnë obezitetin te njerëzit. Në SHBA është bërë një luftë e jashtëzakonshme për vite të tëra kundër kompanive të mëdha të duhanit, derisa është arritur këtu ku jemi sot. Krahasimi çalon, sepse çdo krahasim çalon. Unë shtroj një pyetje: cili është detyrimi juaj për t'i kontrolluar reklamat që transmetohen në mediet e ndryshme, nëse ato janë të sakta, sepse atje thuhet se ky është më i miri etj.? Në fakt, ato vërtet nuk e vrasin njeriun, por e dëmtojnë shumë shëndetin e tij dhe duhet të kontrollohen. Duhet dikush t'i shikojë reklamat, të cilat prodhohen nga dikush që ka interes, duke e bërë reklamën, siç është ajo shprehja "ne nuk jemi më të mirët, por më të mirë se ne nuk ka". Në fakt, ka shumë produkte, të cilat krijojnë probleme te fëmijët, te njerëzit nga zonat rurale, të cilët nuk kanë kulturën e nevojshme, sepse njeriu biologjikisht priret drejt një gjëje të re. Ky është një problem i madh dhe mendoj se AMA është institucioni, i cili me instrumentet, me fuqinë dhe me bashkëpunimin që ka me institucionet e tjera, duhet të ushtrojë detyrën e saj. Edhe në qoftë se ne nuk kemi një institucion, siç e kanë të tjerët, ta ngremë atë.

Në qoftë se nuk e ngremë, ta propozojmë që ta bëjmë me ligj ose ta bëjmë brenda Këshillit të Ankesave. Nuk e di nëse isha i qartë për sa i përket çështjes së fundit. Unë kam një shqetësim shumë të madh, por nuk e di se sa dita ta përcillja në pikëpamje të asaj që duhet të bëjmë për këtë çështje. Besoj se isha brenda thelbit të problemit.

Shumë faleminderit! Shumë suksese në punën tuaj! Ju përgëzoj për punën që keni bërë në vitin 2018!

Gentian Sala – Shumë faleminderit!

Milva Ekonomi – Më falni, zoti Sala! Dëgjojmë edhe dy-tri pyetje të tjera, sepse e menaxhojmë kohën më mirë, pasi mund të jenë pyetje të përsëritura.

Lindita Nikolla – Ju falënderoj për raportimin dhe për detajimin që i keni bërë punës së AMA-s në raport! Në vijim të atyre që përmendi deputeti Ulqini, dua të di më specifikisht se cilat janë risqet që prekin fëmijët. Ju përmendni aty se është bërë progres, por cila ka qenë tipologjia e shkeljeve në këtë drejtim? Nëse kërkon nga ky komision apo nga parlamenti, ne jemi të hapur për të vijuar më tej ndihmën për t'i përmirësuar, për t'i minimizuar apo për t'i çuar drejt zeros të gjitha risqet që vijnë nga media për fëmijët.

Milva Ekonomi – Fjalën e ka zoti Roshi.

Enver Roshi – Faleminderit për paraqitjen e projektraportit të vitit 2018!

Në vijim të diskutimeve të mëparshme dhe të asaj që tha zonja Nikolla, dua të na jepni një shpjegim më të qartë: 40% e ankesave janë për shkelje të të drejtave të fëmijëve, por cila është tipologjia e tyre? Për sa u përket të drejtave të njeriut, për cilat aspekte të tyre e keni fjalën?

Kam edhe një pyetje për reklamat që kanë lidhje me shëndetin: a ka pranë jush një ekspert të fushës së mjekësisë, i cili të japë mendime se si këto reklama të minimizohen ose të hiqen nga tregu i televizioneve?

Më shqetëson shumë edukimi i fëmijëve, duke filluar që nga formimi gjuhësor i emigrantëve që janë jashtë, të cilët mezi mësojnë shqip, për shkak edhe të angazhimeve e të punëve të tyre. Nuk e di nëse është objekt i AMA-s apo jo, sepse unë jam i ri këtu, por ky është një fenomen që më shqetëson, pra edukimi i fëmijëve me gjuhën shqipe, me historinë e Shqipërisë, por edhe me moralin dhe traditat shqiptare.

A e keni në fokus programin e ditës, pra se si është shpërndarja e programeve, sepse shpesh shohim që paradite ka filma me dhunë, me krim apo të gjinive të tjera, që nuk janë edukuese, por çedukuese për fëmijët, sidomos për fëmijët që janë në shtëpi.

Një problem tjetër është ai grupeve vulnerabël, qoftë për njerëzit që nuk shikojnë apo për personat që nuk dëgjojnë: a ka ndonjë projekt për këtë gjë, se si mund t'u vihet në ndihmë

këtyre kategorive njerëzore, të cilat për mungesa të shumta informacioni nuk arrijnë te këto grupe?

Duke ju falënderuar edhe një herë për raportin, shikoj se ka një progres. Jam deputet i ri, zoti Musa e tha se që nga viti 2016, është bërë punë e madhe, por si qytetar, jo si deputet më shqetëson shumë edukimi i fëmijëve dhe i brezit të ri. Kjo është pika më e dhimbshme për ne si komb. Këtë e them me ndjeshmëri, sepse jemi rrahur në shumë drejtime, kemi parë, kemi dëgjuar shumë gjëra. Këtu duhet një bashkëpunim. Ne kemi qenë pushtuar 500 vjet nga Turqia dhe na vijnë filma se Perandoria Osmane ka qenë një perandori e mirë, edukuese. Shpeshherë në vend që të edukojmë fëmijët me histori të vërteta, bëjmë ndoshta edhe një çedukim. Nuk e di nëse është apo jo vendi këtu, por e kam shqetësim, prandaj e ngrita. Ndoshta bëj gabim që e ngrita, ndoshta duhet një mbledhje tjetër për këtë punë, por duhet të qëndrojmë fuqishëm në edukimin atdhetar të fëmijëve me gjuhën shqipe, me historinë e Shqipërisë, me të dhënat reale që ne duhet t'u japim fëmijëve. Ky problem më shqetëson shumë, prandaj do ta ngre edhe në tryeza të tjera.

Milva Ekonomi- Faleminderit!

Pyetjet janë me radhë: zonja Vilma, zonja Mirela dhe zoti Beqiraj. Këtu mbyllet pjesa e pyetjeve.

Vilma Bello - U bashkohem falënderimeve të të gjithë kolegëve për raportimin e të gjithë veprimtarisë suaj. Pyetja ime është vazhdim i pyetjes që bëri kolegu Ulqini, por për ta specifikuar, duke iu referuar situatës së shtatorit të vitit 2018 për mbylljen e transmetimeve analoge në Tiranë dhe në Durrës, si edhe raportimit të veprimtarisë suaj, ku cilësohet se brenda këtij viti do të mbyllet këto transmetime edhe në qarkun e Vlorës. Jam deputete e këtij qarku, prandaj e referoj këtë pyetje: si jemi me informimin për përfundimin e këtyre transmetimeve, për respektimin e këtij afati? Me thënë të drejtën personalisht e kam ndjerë si shqetësim, si një mungesë informimi për këtë proces në këtë qark.

Milva Ekonomi - Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Shumë faleminderit, zoti Sala, për raportin e detajuar!

E prekën pak kolegja Nikolla dhe kolegu Roshi, por kërkova, ndonëse jo deri në detaje, ndoshta nuk e kam parë, qofsha e gabuar, nëse është kështu e tërheq, për të kuptuar pak më shumë rolin e AMA-s në lidhje me tematikën dhe me përmbajtjen.

Pashë monitorimet që ju keni zhvilluar dhe shkaqet për të cilat keni tërhequr vërejtje, por që kanë të bëjnë më shumë me prekjen, cenimin e atij limiti minimal, përtej të cilit nuk duhet të shkohet. Unë mendoj se Autoriteti duhet të ketë rol, dhe siç e kemi të gjithë ne, për të shkruar edhe te ajo se çfarë duhet të bëjmë më shumë. Te pjesa e përmbajtjes tematike,

programet kulturore, programet e edukimit kulturor, në konceptin tim lënë shumë për të dëshiruar në të gjitha kanalet televizive, që nga ato publike, private, kombëtare dhe lokale. Unë e kuptoj dhe jemi përballur gjithmonë me debatin që të tilla programe që nuk kanë karakter komercial, nuk shihen masivisht. Kjo i bën pronarët dhe autorët të mos i lënë një vend të madh këtyre lloj programeve. Unë mendoj se është në rolin tuaj, ndoshta ju mund ta keni bërë, do të doja të kisha më tepër informacion që AMA të mos jetë vetëm te limiti se çfarë nuk duhet të shikojnë, se nga se duhet t'i mbrojmë. Unë i ndoqa të gjitha vërejtjet që keni bërë, janë mbrojtja minimale: jo skena porno, jo skena dhune, jo programe të cilat nxisin qendrimet ekstreme. Por, a nuk duhet të kemi një qasje që të jetë proaktive për të thënë: A duhet që çdo televizion të ketë detyrimisht një program për librin, duhet të ketë një program që të nxisë për gjuhën shqipe? Në mos të gjitha, a nuk duhet t'ua kërkojmë këtë të paktën atyre televizioneve që kanë licencë kombëtare? Ne e dimë influencën e televizioneve sot, jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, por edhe në të gjithë territorin ku ka publik shqipfolës.

Pashë se keni bërë monitorime shumë të detajuara lidhur me ekuilibrat politikë. Singlerisht mendoj se jemi ende mbrapa si vend, për sa kohë vazhdojmë të merremi vetëm me ekuilibrat politikë, që do të thotë që *show* politik vazhdon të zërë pjesën më të madhe të kohës televizive dhe të vëmendjes së publikut. Ky është një problem shumë i madh, që ka të bëjë me mungesën e emancipimit, me mungesë kulturimi. Nëse vetë televizionet shkojnë drejt boksit politik, sepse tërheq më shumë publik, është roli edhe i këtij komisioni, edhe i institucioneve shtetërore, por besoj edhe i AMA-s që të ndikojë për përmbyesjen e këtij raporti. Zëvendësimi i emisioneve politike me emisione kulturore, informuese, të një karakteri më të gjerë, do të jetë një hap drejt emancipimit të shoqërisë. Dita kur do të mbërrijmë në zëvendësimin e një mbrëmjeje të debatit politik me emisione kulturore, edukuese, informuese do të jetë një fitore për të gjithë vendin.

Unë vazhdoj të insistoj se kultura është një emergjencë kombëtare dhe ende nuk po e trajtojmë si të tillë. Ndoshta ju keni monitorime ose nëse nuk i keni, besoj se do të ishte e udhës që në programin tuaj të përfshihen monitorime që monitorojnë pikërisht këtë objektiv, nivelin e emancipimit kulturor dhe të edukimit kulturor të shoqërisë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj- Përshëndetje, zoti Sala, bashkë me ekipin që përfaqësoni sot për të raportuar në këtë komision!

Kam dy fjalë në parantezë. Ju përshëndetën edhe kolegë të tjerë, edhe kolegu i opozitës për punën. Edhe unë i bashkohem këtij falënderimi për punën që ka bërë institucioni juaj.

Institucionin tuaj do ta konsideroja si një arbitër shumë të rreptë të pushtetit të katërt që është media audiovizive në Shqipëri. Nuk po zgjatem në hyrje, por do të bëj disa pyetje që në raport, ndoshta, më kanë kaluar.

Sa për qind zënë ankesat për të drejtën e autorit dhe sa penalitete ka institucioni juaj, këtë duke e krahasuar me vetveten, me një vit më parë, pra me vitin 2017?

Lidhur me shqetësimin e madh publik, social, shoqëror që pati për kalimet e transmetimeve nga analoge në digjitale, dua të pyes sa abonentë janë të pajisur me dekoderë falas të tipit DVB T2 deri tani? Sa është skenari i mundshëm i pajisjes deri në fund, kur të mbyllet edhe transmetimi analog për qarkun e Vlorës, që ju e keni referuar?

Kam edhe një shqetësim nga zona që përfaqësoj, qarku i Fierit, ku nga monitorimet e kryera në qarqet Berat, Korçë dhe Fier, pas mbylljes së transmetimeve analoge, konstatohet se RTSH-ja dhe operatorët privatë nuk mbulojnë zona të caktuara në këto qarqe. Ka shqetësim nga abonentë dhe nga qytetarë të ndryshëm; ky konstatim është edhe te vlerësimi i këtij raporti nga ana e Kuvendit.

Faleminderit.

Milva Ekonomi – Po, zonja Xhembulla. Pastaj zoti Sala do të dëgjojmë përgjigjet tuaja.

Almira Xhembulla - Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj përfaqësuesit e AMA-s për informacionin shumë të detajuar dhe raportin e sjellë për aktivitetin e tyre gjatë vitit 2018! Ne kemi pasur gjatë vitit një marrëdhënie interaktive me njëri-tjetrin qoftë në pjesëmarrjen në aktivitete, qoftë edhe vizitën që bëmë në ambientet e AMA-s, ku morëm një informacion shumë të detajuar për mënyrën se si punohet në departamente dhe si organizohet puna. Duke mos dashur të jem përsëritëse, në lidhje me atë çfarë thanë kolegët, por duke u fokusuar te ankesat, si është marrëdhënia juaj me shoqatat e konsumatorëve, shoqatat e bizneseve, shoqatat që merren me të drejtat e fëmijëve apo me të drejtat e grave? A e konsiderojnë ata AMA-n si një actor, tek i cili do të gjejnë një përgjigje të saktë për problemin se si e gjithë kjo larmishmëri problemesh shfaqet në televizionet shqiptare apo qoftë edhe në gazetat shqiptare? Nëse e kemi në numra, se po të ishin të shtuara rastet e ankesave, do të ishte besoj diçka positive, duke qenë se ata ju konsiderojnë një aleat, një mbrojtës, monitorues i respektimit të ligjit në këtë aspekt.

Milva Ekonomi – Zoti Sala do të merrni fjalën për përgjigjet e gjithë këtyre pyetjeve? Disa më duket se përsërisin edhe njëra-tjetrën, që kështu të mund të bëni një shpjegim shterues.

Gentian Sala – Ju faleminderit!

Pyetja e parë: a do të ketë një shtyrje të procesit të digjitalizimit nga 1 shtatori?

Ndoshta. Për historik, mund të themi se shtyrjet kanë qenë të nevojshme. Ka raste të përsëritura në shumë shtete, nuk është një gjë që po ndodh për herë të parë. Sado që të bësh fushatë informimi, dhe ka pasur shumë, sado dekoderë pa pagesë të kesh shpërndarë, prapëseprapë, në fund të fundit, kur të bëhet real procesi, njerëzit e kuptojnë se çfarë ndodh, pra, kur nuk kanë më sinjal në shtëpi. Nuk besoj se do të ketë më shtyrje në Tiranë e Durrës. Nuk besoj se është e nevojshme. Të mos harrojmë se shtresa e popullsisë që ka ngelur pa dekoderë është shumë e vogël, me aq sa dimë ne, dhe janë shtresat më vulnerabël, që e kanë lënë për në fund fare procesin.

Numri i dekoderëve që janë dhënë pa pagesë, për t'iu përgjigjur edhe njërit prej pyetjeve, është 88 mijë, numër shumë i lartë, pra, që u është dhënë familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike. Kur janë shpërndarë dekoderët, këta kanë qenë të parët që e kanë marrë.

Ne na rezulton se të paktën në Tiranë e Durrës, vetëm nga operatorët privatë duhet të jenë shpërndarë mbi 150 mijë dekoderë. Në janar gjendja rezervë e këtyre operatorëve, nga komunikimi që kemi pasur me ta, ka qenë shumë e ulët. Pra, u detyruam ta shtynim procesin.

Nuk besoj se në Tiranë e Durrës do të ketë shtyrje. Për Vlorën nuk mund ta them me siguri se nuk do të ketë shtyrje. Ndoshta do të jetë e nevojshme. Tashmë eksperiencën e kemi dhe duhet të shihet se kur do të vijë momenti. Të mos harrojmë se për Vlorën shtatori është periudhë e sezonit turistik. Me një fjalë, duhet të jemi në komunikim edhe me institucionet e tjera, në lidhje me Vlorën.

Pyetje shumë e rëndësishme është çështja e lirisë së medias, e pronësisë së medias. Është ngritur si shqetësim edhe nga institucionet ndërkombëtare. Që të jem i sinqertë, zoti Ulqini, jo për karshillëk ndaj institucioneve ndërkombëtare, se nuk e kemi luksin ta bëjmë këtë, por nuk mendoj se është e nevojshme. Tregu audioviziv ka ndryshuar në mënyrë shumë rrënjësore. Të paktën sa i takon institucionit që unë drejtoj, nga 60 punonjës që kemi aty, shumicën e informacionit që marrin, e marrin nëpërmjet internetit. Nuk është më periudha e viteve 1997, 2000, 2005, 2010, kur interneti ka qenë shumë i kufizuar dhe pa televizorin ne nuk kishim çfarë të bënim.

Tregu mediatik është aq i larmishëm dhe aq i ndryshuar, sa unë mendoj se kjo masë nuk është më e nevojshme. Në të gjitha takimet që kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Musa Ulqini – Ideja është që mediet kombëtare janë në duart e dy-tre vetave. Këtu e kam shqetësimin, nuk e kam tek pjesa tjetër, sepse me aq numër televizionesh dhe radios që kemi, në Shqipëri pluralizmi është kaq i garantuar, edhe në raport me vendet e Europës

Perëndimore, me aq sa di unë, sepse kemi më shumë, dhe kur ka më shumë, natyrisht që pluralizmi është i garantuar. Pra, nuk e kisha këtu thelbin. As ndërkombëtarët nuk e kanë pasur këtu shqetësimin. Ne duhet ta përballojmë si problem, se na penalizojnë, kur vjen puna që ulemi në tavolinë përballë me ta. Këtu kemi faj edhe ne, ju kuptoj shumë mirë.

Gentian Sala – Mediet kombëtare kanë qenë në dy-tre duar edhe më parë, por përdornin fiktivitetin. Kush vinte gruan, kush kushëririn, kush miqtë dhe i dimë proceset gjyqësore që janë. Thjesht është ligjëruar me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Unë mund ta kaloja pyetjen, duke thënë edhe që “po, duhet bërë diçka”, por nuk mendoj ashtu. Koha ka ecur përpara aq shumë, sa që informacioni nuk mund të jetë më dot monopol. Dakord, kemi katër televizione kombëtare dhe shumë televizione informative, por çdo takim që kemi me rregullatorët, sidomos europianë, interneti është ai që do të na presë si problematikë, të paktën për pesë vjetët e ardhshme. Pse? Sepse ka ndryshuar mënyra se si merret informacioni. Kjo është më se e garantuar dhe mund ta merrni informacionin nga të dhënat e AKEP-it. Te ne interneti përdoret shumë dhe mund të jemi një ndër pesë vendet e para në Europë për përdorimin e internetit.

Pra, nuk mendoj se kjo do ta shpëtonte lirinë e medias apo problematikat që ka media në Shqipëri në lidhje me monopolin, po themi.

Milva Ekonomi – Musa, mbase duhet të marrim ca informacione edhe nga Autoriteti i Konkurrencës, që kur të përballemi, të kemi edhe disa informacione shtesë.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi.)

Gentian Sala – ...autoriteti i Konkurrencës, kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky është mendimi im, jo i AMA-s si bord. Në lidhje me këtë të jemi shumë të qartë. Bordi është bord; mendimi im si kryetar, është si kryetar. Unë mendoj se koha po ecën aq shpejt, sa e ardhmja është interneti. Të gjitha kompanitë e mëdha po investojnë në internet, media po kalon në internet, ne vazhdojmë të bëjmë kufizime te tregu analog...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi.)

Po ia kaloj fjalën Drejtorit të Programacionit, për të folur në lidhje me çështje të karakterit programor

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arben Muka – Po, për atë do të flas. Te pjesa e reklamave tregtare, zoti Ulqini, që në fillim doja t’ju informoja se bordi, më datën 11 janar, në mbledhjen e parë, temën e parë që ka diskutuar për vitin 2019, ka qenë monitorimi dhe vlerësimi i reklamave dhe komunikimeve tregtare, ku përfshihen reklamat e fshehura në edicionet e lajmeve dhe reklamat mbi shëndetin. Kur them reklamat mbi shëndetin dhe medikamentet, kam parasysh ato emisione, të cilat, jo se

reklamohet për shëndetin, sepse mund të reklamohet në bllokun e reklamave, përdoren në mënyrë abuzive për të promovuar klinika, ekipe mjekësh apo mjekë të caktuar.

Në lidhje të drejtpërdrejtë me shqetësimin që ju ngritët për produktet, zoti Ulqini, duhet ta keni parasysh se cilido subjekt që blen kohë televizive, audio dhe audiovizive, sigurisht do ta bëjë reklamën dhe do të thotë se ka këtë apo atë shërbim. Këtu ne nuk kemi si të ndërhyjmë. Tani, që ta provojmë nëse përmbajtja e kësaj pijeje ka jo këto që thotë ky, por të tjera, këtu zoti Ulqini futemi pak në një problem tjetër. Ne duhej të kishim aty ekspertë të prodhimeve blegtorale, ekspertë të mobilerive, a ku di unë, dhe të thoshim që kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bota e ka kështu. Ndërhyn Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Konkurrenca. Pra, do të thotë se Arben Muka po bën një reklamë për këtë produkt e për këtë shërbim, qytetarët janë ankuar te Konkurrenca, le të ankohen edhe tek ne; ne do t'i drejtohem i po Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe do t'i themi se kjo reklamë që bën kompania X apo ku di unë, apo Arben Muka, se po marr më mirë veten time, për të mos përzierë askënd tjetër, kjo reklamë që bëhet, ky publicitet gënjen dhe mashtron qytetarin për shërbimin. Vetëm deri këtu mund të arrijmë.

Ne i drejtohem menjëherë Autoritetit të Konkurrencës dhe Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit, sepse duhet ekspertizë për këtë punë.

Milva Ekonomi – Në sesionin e kaluar, ne miratuam një ligj që ka të bëjë me përqendrimin e sheqerit dhe të kafeinës në disa produkte që s'lejohej të tregtohen në mënyrë të hapur për personat nën moshën 18 vjeç, pra për fëmijët, për shkak të obezitetit të shtuar në Shqipëri, dalë kjo nga disa studime të bëra nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Ndërkohë, mbase një nga shqetësimet e zotit Ulqini, është edhe ky: a e monitorojmë dot ne këtë kërkesë ligjore nëpërmjet institucionit tuaj, sepse kjo është një nga kërkesat? Domethënë, ne kemi ndaluar me një ligj, sipas të cilit shitja e produkteve që kanë përqendrim të lartë sheqeri apo kafeine dhe blerja në mënyrë individuale nga ana e fëmijëve që nuk janë ende në moshën 18 vjeç, është e ndaluar në Shqipëri. Këtë e kemi lidhur me obezitetin, që është një nga risqet e grupmoshës 5-18 vjeç. Kjo ka ardhur si rezultat i disa kërkimeve që kanë bërë organizatat shqiptare dhe ato ndërkombëtare.

Në këtë rast, a bëni dot një monitorim për të ditur se si shkojnë gjërat në raport me ligjin, apo kjo nuk është e mundur? Në këtë rast, nuk po flas për llojin e produktit, por po flas për zbatimin e ligjit.

Gentian Sala – Me sa di, ligji nuk thotë “ndalohen”, por thotë se “mediet audiovizive kufizohen në përmbajtjen e programeve të caktuara”. Nuk duhet të transmetohen në programet për të mitur e të tjera. Megjithatë, absolutisht që mund ta monitorojmë, absolutisht që kemi punuar. Me t’u miratuar ligji, na ka ardhur kërkesë nga *Coca Cola*, për shembull. Ata janë shumë të ndjeshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. U kemi dhënë sqarimet përkatëse, i kemi lidhur edhe me institucionet e tjera të mbrojtjes së konsumatorit. Që të jemi të sinqertë, kjo është fushë e re për ne. Fushë e konsoliduar tek ne është fusha e produkteve mjekësore. Komunikojmë me Ministrinë e Shëndetësisë, me Urdhrin e Mjekut, Urdhrin e Farmacistit, kemi bërë seminare, kemi bërë trajnime. Pra, kemi shumë njohuri.

Për herë të parë, që nga janari, bordi i AMA-s ka në fokus tri fusha: reklamat tregtare në edicionet informative, produktet mjekësore fokus të veçantë, fëmijët fokus të veçantë.

Pra, për ne është shumë kollaj të bëjmë një listë dëshirash, ta përkthejmë projektligjin, të fokusohemi te kjo dhe te kjo. Nuk vihet dot fokusi tek të gjitha. Ne kemi pasur sukses, sepse jemi marrë me problemet më madhore që kemi gjetur, probleme të natyrës së mospagimit të taksave nga operatorët, probleme të transmetimeve të paligjshme, probleme të licencimit të operatorëve kryesorë dhe, në një farë mënyre, legalizime, ashtu sikurse lejon ligji. Pra, këtë punë nuk mund ta bënim dot para 5 vjetëve, për shembull, t’u thoshim operatorëve se çfarë bëtë me reklamën e produkteve tregtare. Tani është koha që fokusi të jetë te programacioni. Këtë vit dhe vitet në vazhdim janë vetëm programacion.

Për çështjen e zbatimit të ligjit në fjalë, mund të marrim angazhim që do ta shohim me prioritet dhe, pse jo, t’ju informojmë si komision për çfarë bëhet dhe të gjejmë një zgjidhje.

Po e përsëris që te emisionet e fëmijëve duhet të ketë kufizime.

Urim Bajrami – Do t’i bashkoja në një përgjigje të dyja pyetjet, pyetjet e zonjës Nikolla dhe pyetjet e zotit Roshi.

Mund të them që pjesa më e madhe e ankesave që kanë ardhur për fëmijët, lidhet me identifikimin e tyre të tërthortë. Në raste të caktuara ka pasur edhe identifikim të drejtpërdrejt dhe cenim të privasisë.

Rekordi i transmetimit është shumë i qartë, ka sanksione të ashpra lidhur me fëmijët. Ka një seksion të veçantë pikërisht për këtë gjë dhe janë shprehur në mënyrë eksplicite.

Ajo çfarë mund të them është që në rastet e fëmijëve ka një përmirësim, atë çka theksova edhe në raportimin paraprak. Nëse më parë ne kishim vënë re se fëmijët intervistoheshin pa marrë masat përkatëse, pa u retushuar, kjo pothuajse është shmangur, ndërkohë ke identifikim të tërthortë.

Edhe vetë prindërit duhet të sensibilizohen, sepse kemi pasur raste kohët e fundit që, për të përfituar diçka, prindërit kanë nxjerr një fëmijë duke qarë në ekran, pa e kuptuar se fëmija ka të drejtat e veta. Ne jemi përherë në vazhden e aktiviteteve dhe trajnimeve pikërisht për të shmangur këto gjëra.

Kjo ishte për fëmijët, për dy rreziqet kryesore që kishin të bënin me fëmijët, pra identifikimi i tërthorë, se identifikimi i drejtpërdrejtë po shmanget, megjithatë ky përmirësim ka çuar edhe në respektimin e normave dhe parimeve ligjore dhe etike për sa u përket fëmijëve.

Pyetjes së zotit Roshi në lidhje me cenimin e dinjitetit të të drejtave të njeriut, po sqaroj se janë pak raste që lidhen me këtë. Më së shumti lidhen me çështjet civile që kanë palët në transmetime.

Në vijim të kësaj, pyetja ishte për grupet vulnerabël. Ligji parashikon që televizionet kombëtare duhet të kenë të paktën një edicion lajmesh për komunitetet me nevoja të veçanta shqisore, në këtë rast bëhet fjalë edhe për ata që nuk dëgjojnë. Aktualisht ka vetëm TVSH-ja një edicion për grupet vulnerabël. Ne jemi në kontakt me televizionet e tjera, të cilave u kemi kërkuar që në bazë të ligjit, duhet të kenë një edicion të tillë lajmesh.

Duhet të kuptojmë se kjo ka një kosto shtesë për televizionet; gjithsesi kjo është në fokusin tonë për ta zgjidhur dhe për t'i dhënë udhë sa më shpejt.

Nuk e di nëse isha shterues në këto përgjigje.

Milva Ekonomi – Për çështjen e fëmijëve ne kemi një grup që është ndërkomisionar, çdo komision i përhershëm ka disa përfaqësues atje, e kam fjalën për grupin “Miq të fëmijëve”, dhe në mënyrë të vazhdueshme ne raportojmë për situatën e fëmijëve në Shqipëri. Në një nga takimet që kemi bërë me përfaqësuesit e shoqërisë civile, na kanë prezantuar një kërkesë dhe kërkesa ka qenë pikërisht që të monitorohen më shumë nga televizionet shqiptare rastet e dhunës ndaj fëmijëve.

Ndërkohë duhet të kemi disa informacione më të përditësuara për raportimin e rastit dhe ndjekjen e rastit. Këtë mund ta vëmë edhe si një kërkesë shtesë në rezolutën e vitit 2019, si një çështjet që ka sensibilitet të brendshëm shumë të lartë në parlament.

Arben Muka – Kjo që thatë ju, zonja Ekonomi, është e vërtetë dhe do të orientohemi patjetër, si reflektim i rezolutës së këtij viti. Unë do të shtoja se AMA, sigurisht është një gjë ekstra që është përmendur pak edhe në raport, për çështjen e fëmijëve bën sinergji me organizata partnere, për përmirësimin e raportimit për çështjet dhe problemet e fëmijëve.

Pra, ky është një aspekt, sepse AMA, këtë ua thamë edhe gjatë vizitës që bëtë në ambiente tona, jo e ka të vështirë, por e ka të ndaluar të bëjë trajnime dhe kualifikime, sepse ne jemi respektues të ligjit dhe të akteve nënligjore, por bëjmë sinergji me organizata, me shoqata

të shoqërisë civile, me institucione të specializuara për trajnimin e gazetarëve, me qëllim përmirësimin e raportimit për fëmijët.

A matet niveli kulturor, ishte një pyetje e drejtpërdrejt e zonjës Kumbaro. Sigurisht, problemi që ju ngrini është esencial, sepse në themi që media ka rolin informativ, ka edhe rolin argëtues, por ka mbi të gjitha rolin edukativ.

Unë e mbështes shqetësimin tuaj, por në kemi një problem. Sigurisht, në mund të bëjmë vlerësime, në mund të bëjmë monitorime, në fakt nuk jemi organizëm i specializuar për monitorime sasiore dhe cilësore, por sigurisht monitorime në aspektin se çfarë kanë televizionet, sidomos ata që kanë impakt kombëtar, patjetër që e bëjmë. Problemi ynë është vetëm ndërhyrja në menu, ajo që ju e ngritët me shumë shqetësim, që është futur tek-tuk ndonjë emision libri, dhe unë jam plotësisht dakord me ju, por problemi është se AMA e ka të vështirë të bëjë agjendën ose skaletën programore të televizioneve.

Veprimtaria audiovizive, thotë ligji, është e lirë. Nëse ajo i ka emisionet kulturore, por ato janë me nivel të ulët...

Mirela Kumbaro – Sigurisht, jam shumë dakord me ju dhe nuk më shkon ndër mend që ju të bëni ndërhyrje në menu, por për sa kohë ju, në dhe gjithë shoqëria do të vazhdojmë ta mendojmë problemin e edukimit kulturor si një çështje dytësore, jo dytësorë, por dhjetësore apo prapa liste, nuk kemi për të bërë asnjë hap përpara. Mua nuk më shkon ndër mend që ju të bëni ndërhyrje në menu, por siç bëhet monitorimi i ekuilibrave politikë. Ju kishit një monitorim shumë të detajuar se sa minuta flet kjo parti dhe sa kjo tjetra. Bëni një ekspertim në muaj, sepse nuk është çështja që media e ka rol, por e ka detyrim ligjor. Në qoftë se AMA dhe ne, si komision, nuk e ngremë këtë dhe ta themi që është parësore, do të na duhem shekuj për të arritur tek ajo që ne mendojmë si standard europian të emancipimit të shoqërisë.

Ne, edhe kur flasim në mënyrë të pandërgjegjshme, shprehim në fakt një paragjykim që lajmet e kulturës, edukimi kulturor, çështjet e kulturës, janë ca probleme, të cilat janë çështje qejfi. Jo, jo, kjo është çështje ekzistenciale.

Ju thoni se mbrojmë fëmijët nga emisionet porno, por emisionet porno i kemi në debatet politike. A bëhet monitorim për këtë element? Është qasje, është mentalitet që duhet të fillojë të ndryshojë dhe unë besoj se institucionet si komisioni ynë, si AMA apo të tjera institucione, duhet të fillojnë ta kenë këtë ndërgjegjësim, pastaj dalëngadalë do të fillojmë që media vetë do të bëjë një ndryshim.

Ju sillni një raport, ku thoni se një muaj eksperimentuam dhe monitoruam se cila është sasia, nuk po them cilësia, e emisioneve me karakter kulturor në të gjitha mediat tona. Do të ishte shumë interesante ta bënim këtë analizë dhe do të ishte një sinjal alarmi, pastaj, që ndoshta

të tjerë aktorë të shoqërisë do të mund të reagojnë, por na duhet në fillim ta ndryshojmë mentalitetin brenda vetes sonë.

(Ndërprerje incizimi.)

Gentian Sala – AMA mund të shikojë respektimin e buqetës programore, për të cilën i ka dhënë licencën operatorit. Pa dyshim, aty janë edhe çështjet programore. AMA mund të bëjë patjetër monitorim sasior, mund t'i bëjë të gjitha këto, por duhet të keni parasysh një gjë, që këtu ka një kulturë 20-vjeçare televizionesh që kanë këtë lloj tipologjie, janë shumë agresivë, janë fokusuar shumë te politika. Pse? Hajde ta analizojmë pse ka nga 5-6 emisione politike në ditë dhe jo emisione kulturore. Siç bëjmë takime apo konferenca për të drejtat e gazetarëve, të drejtat e fëmijëve, hajde të diskutojmë pse situata është e tillë te mediet audiovizive apo, pse jo, vetëm nga televizori dhe emisionet, por, më vjen keq ta them, ne nga Kuvendi i Shqipërisë kemi dëgjuar seanca...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hajdeni bëjmë një analizë pse është kjo gjendje. Megjithatë, për të qenë tejet i sinqertë, shpresën kryesore e shoh tek operatori publik, i cili, për vetë natyrën që ka, për vetë formatin më të relaksuar që ka... Pse? Sepse fondet i ka të garantuara, nuk është ai që në fund të muajit sheh nëse do të dalë me fitim apo me humbje. Unë them se operatori publik është ai që duhet të bëjë diferencën e natyrës së programeve dhe, në fakt, po e bën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në momentin kur operatori publik nuk do ta ketë mendjen, siç nuk e ka, te sa është audienca e këtij momenti të televizionit, por te thelbi dhe te thellësia e zhvillimit të një debati kulturor etj., është pikërisht ai që duhet ta bëjë diferencën.

Në qoftë se ne do të shohim që operatorët privatë do të jenë ata që do të bëjnë ndryshimin, së pari, mendoj se do ta kemi shumë të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ose publik, ose privat jemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të flasim sinqerisht edhe për çështjen e telenovelave turke: ka që i pëlqejnë, ka që nuk i pëlqejnë. Por, në radhë të parë, ne kemi ligjin, i cili në nenin 35 thotë: “OSHMA-të u rezervojnë veprave europiane shumicën e kohës së tyre të transmetimit” etj.. Pastaj në pikën 52 të nenit 3, thuhet se cilat janë veprat europiane: “Veprat europiane janë veprat me origjinë nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe veprat që kanë origjinën në shtete të cilat janë palë në Konventën Europiane për Televizionet Ndërkufitare të Këshillit të Europës”, ku hyn edhe Turqia. Pra, të jemi shumë të sinqertë, ne i kemi futur vetë në ligjin tonë si vepra

europiane; po ashtu duhet të jem i sinqertë se janë prodhime që transmetohen në të paktën 125 vende të botës. Në qoftë se ne do ta mbrojmë kulturën tonë duke thënë se nuk lejohet kultura e tjetrit... Pra, hajde të punojmë që t'i konsolidojmë vetë televizionet tona, ndërgjegjen tonë kombëtare, me emisione educative, informative dhe e mbrojmë pastaj publikun nga të gjitha ato që mund të quhen influenca të tjera, që dikujt i pëlqejnë, dikujt jo, por që janë vepra europiane në ligjin tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lidhur me pyetjen: “Sa ankesa ka për të drejtën e autorit?”, të drejtat e transmetimit futen tek të drejtat e autorit, por këto të drejta u përkasin më shumë kompanive të mëdha, si: “Tring” e “Dixhitalb”, që kanë të bëjnë me sportet e të tjerë.

Për sa u përket të drejtave të autorit, të jem shumë i sinqertë, kemi ndenjur disi indiferentë nga ky proces. Pse? Sepse ligji në të njëjtën kohë i ka dhënë edhe Autoritetit të Medieve të drejtën për të vënë, le të themi, gjoba, por është edhe një Inspektorat i të Drejtave të Autorit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai tashmë është ndryshuar dhe ka kaluar pranë Ministrisë së Financave.

Në vazhdimësi kemi pasur një konflikt, për arsyen se duhet të kishte transparencë se cili institucion i vinte gjobë një televizioni. A mund t'i shmangnim gjobat, pra të mos punonim dy institucione për të njëjtën fushë? Prandaj ne kemi ndenjur indiferentë ndaj kësaj, për të vënë gjoba për këto të drejta. Jo për t'i ndërgjegjësuar operatorët, por ne nuk mund t'u vëmë gjoba televizioneve, kur ka dy institucione që punojnë në të njëjtin drejtim. Pra, le të themi se ka pasur përplasje ndërinstytucionale. Por këtë vit e kemi tejkaluar këtë përplasje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me Sportelin Unik të të Drejtave kemi një marrëveshje dhe ka një bashkëpunim me hapa pozitivë fillestarë. Urojmë të vazhdojmë në këtë rrugë.

Lidhur me pyetjen: “Sa abonentë janë pajisur me dekodera falas?”, e thamë, janë 88 mijë, që i ka paguar buxheti i shtetit, por mund të themi që edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtu jemi të bindur se nuk ka monopol të shitjes së dekoderave, çështje të cilën e kam dëgjuar shpesh, por janë të paktën tetë kompani të mëdha që fusin dekodera, pra jo një, jo dy, jo tre, jo katër. Dakord, disa kanë avantazhe më të mëdha, sepse kanë një historik të shitjes së këtyre dekoderave, kanë mënyra marketingu më të sofistikuar dhe më të shtjelluara, patjetër që disa shesin më shumë dekodera se disa të tjerë apo ka kompani, si “Tringu” dhe “Dixhitalbi”, që bëjnë oferta, le të themi, më joshëse për këtë çështje. Pse? Sepse u ofrojnë edhe *content* falas

qytetarëve dhe kanë një avantazh ose janë një hap para, kur vjen puna e shitjes së dekoderave. Por, e përsëris, janë të paktën tetë kompani që shesin dekodera me shumicë, ndërsa me pakicë janë me dhjetëra.

Lidhur me pyetjen: “Si është mbulimi me sinjal në qarkun e Fierit”...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për Korçën, Beratin dhe Fierin? Në faqet 14-15 të raportit janë përgjithësisht të detajuara, por ka zona të thella ku, për shembull, operatori publik në qarqet Berat dhe Korçë ka pasur një problematikë me njësinë administrative Rroshnik, Sinjë, Potem, Çepan ose me njësinë Voskopojë, Dardhë, Çërravë, Gorë, Barmash.

Po marrim një rast. Është normale. Nuk është ndonjë çudi pse në relievin tonë kaq të thyer mund të ketë zona shumë të thella ku nuk transmetohet. Operatori publik, me sa jam në dijeni dhe në kontakt të vazhdueshëm, do ta zgjidhë këtë vit këtë problem me sinjal satelitor. Do t’u çojnë familjeve dekodera, do t’u çojnë sinjal satelitor. Megjithatë, si numër popullsie edhe në këto zona, unë kam përshtypjen se janë brenda përkufizimit ligjor.

Operatorët “Top Channel”, “Dixhitalb”, “Vizion” mbulojnë pjesërisht Bashkinë e Divjakës. Në qarkun e Korçës, operatorët “Top Channel”, “Klan”, “Dixhitalb” dhe “Vizion” kanë probleme me njësinë Ersekë, Leskovik, Voskopojë, Dardhë, Çërravë, Mokër. Megjithatë, operatori publik këtu është me sinjal shumë të mirë, kështu që të paktën jemi të sigurt që nuk ka probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I keni në raport. Është një gjë shumë e thjeshtë për t’u identifikuar.

Të mos harrojmë se ne kemi edhe *call center*-in pranë AMA-s, i cili pret me dhjetëra ankesa të kësaj natyre dhe shumë prej tyre janë zgjidhur, sidomos nga operatori publik.

Ne i kemi dhënë fokus operatorit publik, sepse detyrimin ligjor e ka goxha më të madh, por edhe sepse operatorëve privatë, në momentin e marrjes së licencave, u është lënë një afat dyvjeçar dhe pesëvjeçar për mbulimin total të sinjalit. Ndërkohë, operatori publik është ai që ka një detyrim shtesë për vetë faktin se, në fund të fundit, paguhet direkt nga qytetarët.

Milva Ekonomi – Kishte përgjigje të tjera, apo mbaruam?

Gentian Sala – Zonja Xhembulla bëri një pyetje: “Si i kemi marrëdhëniet me Shoqatën e Konsumatorëve, Shoqatën e Grave”...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi takime të vazhdueshme. Për atë që mund ta them me shumë krenari, në fakt, me shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe shoqatat për produktet farmaceutike, jemi në fazë shumë të mirë për të dhënë efekt direkt te konsumatori.

Me keqardhje konstatojmë që në vitin 2018 kemi qenë vetëm te paralajmërimet dhe vërejtjet. Shohim që operatorët veprojnë në një mënyrë, le të themi, tejet të ngadaltë, sepse kanë direkt përfitime ekonomike nga këto.

Unë mund të them se këtë vit nuk kemi rrugë tjetër përveçse të vijojmë me sanksione edhe më të thelluara, që mund të jenë gjrobat, sepse, në momentin që një herë, dy herë, nuk sheh reflektim tek ato pika që kemi prioritare, po i përmend meqenëse kemi edhe operatorët këtu: reklama tregtare në lajme, tek edicionet informative, reklamat e produkteve farmaceutike dhe me emisionet e shëndetit, si dhe reklamat e fëmijëve, do të jemi shumë pedantë. Mirëkuptimin patjetër e kërkojmë, por duhet të vazhdojmë edhe përtej tij.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Shumë faleminderit, zoti Sala!

Unë dua ta përmbyll takimin e sotëm me disa gjëra, për të cilat ne po përgatitemi për t'i vënë në rezolutën e vitit 2019, por natyrisht për këtë do të kemi nevojë të konsultohemi edhe një herë.

Duke e lexuar me shumë kujdes jo vetëm unë, por edhe të gjithë anëtarët e komisionit, raportin që ju dorëzuat, vumë re se të gjitha rekomandimet e rezolutës së Kuvendit për vitin 2018 janë marrë në konsideratë. Gjithashtu, nisur nga veprimtaria e Këshillit të Ankesave pranë AMA-s ose Bordit të Ankesave, siç jemi mësuar ta thërrasim ne në gjuhën e brendshme të komisionit, ajo çka reflektohet në bilancin tuaj të veprimtarisë ekonomike tregon një rënie të lehtë të të ardhurave nga gjrobat, kamatëvonesat apo autorizimet e vogla. Kjo tregon se edhe detyra që ka bërë vetë Bordi i Ankesave brenda jush, ka operuar në mënyrë të tillë, duke gjetur sinergji për të dhënë disa informacione që duhen për tregun. Të paktën unë këtë analizë dhe këtë justifikim i kam bërë kësaj shifre në bilancin tuaj.

Por pavarësisht nga kjo, ajo që na shqetëson është që ne duhet të jemi shumë vigjilentë lidhur me kalimin në transmetimin numerik, ndaj pajisja e të gjitha familjeve shqiptare me dekodera është një çështje e rëndësishme, sepse tentuam dhe kuptuam se, pavarësisht nga tetë operatorët e shumicës në treg që ofruan dekodera, nevoja për pajisjen me dekoder pati një fluks në një moment të caktuar, që solli një ngërç në treg. Për rrjedhojë, ju u detyruat, natyrisht edhe ne patëm shqetësimin, që kjo periudhë kohore të shtrihej më tej. Prandaj kemi shumë nevojë që ju të monitoroni nga afër pajisjet dhe mbulimin me dekoder për të gjithë përdoruesit e kësaj pajisjeje në Shqipëri. Kështu që do të bëjmë kujdes edhe në vitin 2019.

Nga ana tjetër, ne gjykojmë që, sikurse keni bërë vazhdimisht, pra e keni monitoruar situatën paraprakisht lidhur me shpërndarjen e dekoderave, të mos hiqni dorë nga kjo analizë

paraprake, që i bëni gjendjes në terren. Kështu, edhe për këtë vit, për sa kohë që ky proces është ende në zbatim, do të këshillojmë që ju ta bënit sërish këtë matje paraprake të situatës.

Ne dëgjuam këtu edhe raportet e punës dhe marrëdhëniet e punës midis gazetarëve dhe punëmarrësve të tyre. Kemi zhvilluar disa takime lidhur me sigurimin në punë, lidhur me mundësinë e vetërregullimit të medieve. Ju keni pasur një iniciativë dhe keni qenë një promotor shumë i rëndësishëm në treg lidhur me të drejtën që kanë gazetarët për t'u paguar më mirë, për të pasur të paguara sigurimet shoqërore dhe gjëra të tjera si këto. Ndërkohë, edhe nga botimet që bëjnë institucione të ndryshme për situatën e medias në Shqipëri, për shembull, progresraporti i BE-së, *Freedom House*-i apo Këshilli i Europës, kjo çështje mbetet. Kështu që ju inkurajoj sërish që roli që keni pasur për të nxitur këtë marrëdhënie të mirë të punës midis gazetarëve dhe punëmarrësve të tyre, të vazhdojë të jetë në qendër të vëmendjes suaj.

Duke pasur parasysh edhe diçka tjetër, të cilën e diskutuam edhe sot lidhur me Bordin e Ankesave dhe nga ankesat që bëhen, një nga gjërat që vumë re ishte ajo që lidhej me reklamat dhe me konsumatorët. Mos do të ishte e udhës të nënshkruani një memorandum bashkëpunimi me Komisionin Kombëtar të Mbrojtjes së Konsumatorëve?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Domethënë, qenkemi në të njëjtën linjë, sepse mendojmë se është diçka e mirë!

Një tjetër gjë e rëndësishme për ne është kjo: duke pasur parasysh që tregu digjital i informacionit në Europë sot ka edhe dinamika, për shembull, pamë që vjet ata bënë një ndryshim të ligjit të tyre për transmetimet audiovizive në Europë, do t'ju inkurajojmë të ndiqni të gjitha ndryshimet ligjore që ndodhin në Bashkimin Europian lidhur me këtë treg, që t'i pasqyroni në veprimtarinë tuaj.

Diçka e rëndësishme për ne do të ishte edhe vazhdimi i punës suaj për piraterinë televizive. Këto ditë, nëse e keni marrë, Bashkimi Europian ka ndërmarrë një nismë ligjore për piraterinë në internet. Mbase këto gjëra janë të rëndësishme, sepse edhe ne po bëhemi gati për të parë se si mund ta rregullojmë më mirë veprimtarinë e portaleve. Kemi asistuar bashkë në disa dëgjesa, që janë bërë nga organizatat ndërkombëtare, por edhe në një konferencë ndërkombëtare që u bë në Shqipëri në kuadrin e AT-ës lidhur me shpifjen *online* dhe kontrollin e veprimtarisë së portaleve. Çfarë zbatojnë vendet e tjera, duhet t'i kemi parasysh edhe ne. Ju inkurajojmë që edhe ju të keni ndjeshmërinë që të shikoni se si zhvillohen këto ngjarje edhe në vende të tjera të rajonit dhe të Europës.

Nga ana tjetër, do të vazhdojmë t'ju përgëzojmë për veprimtarinë tuaj shumë skrupuloze lidhur me transparencën. Ju keni vendosur në *websait* të gjitha raportet që prodhon organizata. Kemi thënë që kjo është një arritje dhe mbase printimi në letër nuk është aq i

domosdoshëm sa kjo që bëni në internet. Ju inkurajojmë që të vazhdojnë të bëhen transparente të gjitha veprimtaritë që ju merrni përsipër, sidomos kjo që lidhet me ankesat.

Diçka tjetër, për të cilin duam t'ju inkurajojmë, është bashkëpunimi juaj me RTSH-në. Për ne është e rëndësishme, sepse forma që keni zgjedhur, që e keni vendosur atë në krye apo në qendër të të gjithë veprimtarisë audiovizive në Shqipëri, për të krijuar një model, të ishte gjithashtu një qasje, e cila kërkon më tepër inkurajim nga ju.

Natyrisht, ne do ta vazhdojmë kontrollin parlamentar, duke ardhur për të diskutuar me ju për çështje edhe më specifike, jo vetëm për ato që kanë karakter të përgjithshëm, të cilat depozitohen këtu në komision.

Siç e keni parë, gjatë këtij viti ne kemi ndjekur edhe korrespondencën që kanë pasur individë ose shoqata të ndryshme për veprimtarinë tuaj, të RTSH-së apo edhe të Autoritetit të Konkurrencës. Kështu që edhe këtë rol që kemi pasur, si ndjekës të kërkesave apo të ankesave që vijnë nga publiku në emër të komisionit për ju, do ta vazhdojmë ta ndjekim dhe do të jemi të hapur, siç kemi qenë deri tani.

Ju jemi shumë mirënjohës për punën që keni bërë këtë vit. Do të takohemi së shpejti, sepse kemi edhe dy takime të tjera, njëri këtu në komision dhe tjetri në seancë. Kështu që shumë faleminderit! Punë të mbarë!

Falënderoj ju dhe stafin tuaj! Kur erdhëm të bënim vizitën pamë që ju kishit një staf shumë të devotshëm. Të gjithë punonin shumë, prandaj përcilljani falënderimet tona stafit.

Në rendin e ditës kishim edhe miratimin e procesverbalit të datës 19 mars, e cili n aka ardhur i përfunduar.

A jeni dakord me procesverbalin? Dakord. Miratohet.

Tani kam edhe diçka tjetër që lidhet me kërkesën që ne i bëmë OSBE-së për të na mbuluar 3 aktivitetet: në Korçë, Fier dhe Shkodër. OSBE-ja u përgjigj pozitivisht, por kërkon kalendarin e veprimeve, duke na lajmëruar se në data 1-8 prill dhe 8-10 prill e ka të pamundur, ndërsa nga data 10 prill deri në datën 1 maj ata kanë mundësi të na mbështesin. Gjithashtu, edhe përgjigjja për të bërë vizitën në Kosovë u miratua nga Kryetari i Kuvendit dhe është komunikuar me komisionin e Kosovës. Po ashtu kemi lënë një vizitë për tek Universiteti i Sporteve.

Nisur nga fakti që ne të enjten nuk e kemi ditë seance, a mendoni që të shkojmë tek universiteti të enjten?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë e lëmë për të hënë, por planifikojeni, sepse e hëna do të jetë një ditë e gjatë pune, sepse do të miratojmë projektrezolutën e AMA-s.

A ka ardhur raporti i RTSH-së?

Ne do të kemi parasysh që vizitat tona nuk duhet të biejnë ditëve të enjte, kështu që mund të shkojmë të hënën dhe të vijmë të martën, ose mund të shkojmë të martën dhe të vijmë të mërkurën në darkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të hënën në mëngjes duhet të jemi prezent në mbledhjen e grupit.

Fidel Ylli – Të hënën mbarojmë mbledhjen, nisemi dhe kemi edhe të martën paradite për punë.

Milva Ekonomi- Faleminderit! Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA